



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 45 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27/04/2022

VENDIM
Nr.12, datë 27 /04/2022

PËR

**PROJEKTIN E ZBATIMIT PËR REHABILITIMIN E TUNELIT TË SHKARKIMIT NË DIGËN
E ZADEJËS**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.04.2022 mori në shqyrtim Projektin e Zbatimit të paraqitur nga Korporata Energjitike Shqiptare (KESH) për rehabilitimin e tunelit të shkarkimit në digën e Zadejës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ardhur rezultonte se gjëndja aktuale e tunelit të shkarkimit është problematika dhe është e nevojshme rehabilitimi i disa pjesëve të saj tek muret, dyshemeja dhe bashkimi i dy pjesëve në hyrje të tunelit.

Gjithashtu, llogaritja dhe modelimi hidraulik në lidhje me kapacitetin maksimal të mundshëm të shkarkimit nga ky tunel rezulton se ishte i domosdoshëm për menaxhimin e prurjeve të mëdha në rezervuarin e HEC Vau i Dejës.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

VENDOSI:

- 1- Bazuar në VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Neni 27, pika 4, **KESH mund të kryejë zbatimin e punimeve për Rehabilitimin e tunelit të shkarkimit katastrofik ekzistues edhe pa miratimin e KKDM.**
- 2- Ti kërkojë KESH:
 - Të zbatojë gjatë shkarkimit të plotave, kërkesën dhe përfundimin e nxjerre nga projektuesit në lidhje me kapacitetin maksimal të mundshëm të shkarkimeve të prurjeve të mëdha nga ky tunel i cili nuk duhet të shkarkojë në total me shume se 2 000 m3/sek.
 - Të dorëzojë pranë KKDM, në përfundim të punimeve të rehabilitimit, projektin e zbatimit sipas faktit si dhe aktin e kolaudimit përkatës të punimeve të kryera.
 - Të respektojë masat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve në tunel sipas legjislacionit në fuqi.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

